



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2020:180791  
Datë: 28.12.2023  
Numri i dokumentit: 05227980

**PPP.nr.3191/20**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtaren Fatbardha Uka Ibrahimimi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit KRM “P.” Sh.a, me seli në P., kundër debitorit D.A. nga P., lidhur me çështjen përmbarimore, për shkak të borxhit në shumën prej 136.50 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër urdhrin përmbarimor P.nr.949/20, të datës 06.11.2020, të lejuar nga përmbaruesi privat Irfan Kërçagu, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.12.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** prapësimi i debitorit D.A., nga P., **SHFUQIZOHET** Urdhri përmbarimor P.nr. 949/20, i datës 06.11.2020, lejuar nga përmbaruesi privat Irfan Kërçagu, për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

**A r s y e t i m**

Përmbaruesi privat, Irfan Kërçagu si organ përmbarues, sipas propozimit të kreditorit KRM., “P.” ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.949/20 të datës 06.11.2020, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për periudhën kohore nga viti 01.01.2005 deri më 01.01.2009, në shumë prej 136.50 €, me të cilin ka kërkuar që debitori të obligohet që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin t’i paguaj kreditorit borxhin me kamatë prej 8% nga dita e lejimit të përmbarimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kundër urdhrin përmbarimor P.nr.949/20 të datës 06.11.2020, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim debitori, me ç’rast ka theksuar se kërkesa e kreditorit i referohet borxhit të periudhës

2005-2009 ndërsa propozimi për përmbarim përmes përmbaruesit privat është parashtruar më datë 05.11.2020, e që për të gjitha faturat e arritura mbas një viti sipas Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve konsiderohen të parashkruara, në kuptim të dispozitave të nenit 360 par.1.1. të LMD – Ligji Nr. 04/L-077. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit dhe abroget propozimi për përmbarim i përmbaruesit privat Irfan Kërçagu P.nr. 949/2020 i datës 05.11.2020.

Kreditori në përgjigje në prapsim ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar me arsyetimin se raporti i kreditorit me debitorin është i rregulluar me norma të karakterit imperativ, pra baza juridike për faturim mbi shërbimet e kryera është në dispozitat e aplikueshme ligjore dhe tarifata zyrtare. Ka shtuar se i përkujtohet debitorit se punëtorët e kompanisë kredituese, në vazhdimësi kanë kryer shërbimet duke marrë parasysh punën në kushtë të rënda e që si e tillë duhet vlerësuar rëndësinë e shëndetit publik, të pastërtisë dhe higjienës së përgjithshme. I ka propozuar gjykatës që urdhri për përmbarim të mbetet në fuqi dhe propozimi të përmbarohet, ndërsa kundërshtimet e debitorit të refuzohen të pabazuara.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare nr.29/78), e cila ka qenë në fuqi për periudhën e krijimit të të borxhit, përkatësisht nga data 01.01.2005 deri më datë 01.01.2009, ashtu që sipas nenit 378 të këtij Ligji parashihet se: *“Parashkruhen për një vjet: kërkesa për kompensimit për livrimin e energjisë elektrike e të ngrohjes, gazit, ujit dhe shërbimet e spastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e pastërtisë, kur livrimi respektivisht shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”* ndërsa sipas po të njëjtit nen përcaktohet se *“Parashikimi rrjedh gjithëse livrimet apo shërbimet janë zgjatur”*. Rrjedhimisht, kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë, dhe se i njëjti nuk ka ofruar asnjë dokument-dëshmi që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Sipas nenit 43 par. 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore, përcaktohet se: *“Përmbaruesit privat nxjerrin urdhrin për përmbarueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbarueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin të përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Gjykata, analizoj pretendimet e kreditorit të parashtruara sipas përgjigjes në prapësim, mirëpo te njëjta nuk kishin rëndësi vendimtare në vendosjen ndryshe sipas dispozitivit të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar, prandaj shfuqizoj urdhrin përmabrimor.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PPP.nr.3191/20, datë 28.12.2023**

**Gj y q t a r j a**  
**Fatbardha Uka Ibrahim**

***KËSHILLA JURIDIKE:*** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej shtatë (7) ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.